

## Kundra-replike

I nderum kolegu Astrit Kola

M' duhet t' pranoj se kam mbetë i habitun prej botimit qi i batë ju reagimit epigramatik qi u çova. E quj një precedent transparence per një gazete partiake, qi n' Shqipni jane gazeta t' blindume me dogmen partiake. Por, n' anen tjetër, shpresoj qi ju me tregu t' njajtin lojalitet edhe n' rrafsh t' debatit, tuj iu nanshtreue forces s' argumentit, qka asht treguesi i lojalitetit intelektual. Me pranu se ke t' drejte nuk asht e veshtire, e veshtire asht me pranu se nuk ke t' drejte. Ket e kam kuptu prej angazhimit tem n' publicistike. Tash sa i perket shkrimit tuj, po ju baj me dije:

1. Ju thoni se *“Në vitin 1924 nuk ka patur parti të majtë”*.

Nuk e kuptoj se qfare konsideroni ju me termin “parti”, por n' rast se nuk ka pasë t' majte, madje leniniste, atehere kush e bani Revolucionin leninist t' Qershorit, per t' cilin Ahmet Zogu kur u rikthye n' pushtet u shpreh se instaloi një regjim komunist t' cilin ai (Zogu) e rrzoi. Tuj mohu ekzistencen e parties s' majte, ju jeni tuj e qitë Zogun si një mashtrues, qka nuk asht e vertetë sa i perket ktij episodi.

2. Ju thoni se tuj analizu programin politik t' Partis Popullore del se kjo parti nuk ka pasë qenë e majte dhe prej knej konkludoni se bie poshte pretendimi tem (i K. Myftarajt) se A. Zogu hyni n' politike n' rradhet e një partie t' majte.

Por, z. Kola, kriteri me definu profilin e një partie politike, veqanrisht n' politiken shqiptare, nuk asht ajo qka thote, por ajo q' ka ban. PKSH kur u kriju dhe deri n' 1948 zyrtarisht pretendojte se ajo luftoi per “çlirimin” e vendit prej pushtuesve t' huj dhe jo me instalue komunizmin. Por, realiteti tregon ndryshe. Ju e patë vet se edhe n' 29 nantor 2004, pas 60 vitesh prej okupimit komunist t' Shqipnis, ata paten paturpsin me pretendu se nuk kane luftu per komunizmin, por per “çlirimin” e atdheut.

Pranej, edhe Partia Popullore e viteve t' njizeta duhet definu sipas mnyres si veptoi dhe jo sipas mnyres si u deklarojte. Partia Popullore qe berthama e grupimeve qi bane Revolucionin e vitit 1924. Ajo qe berthama e bolshevizmit n' Shqipni. Ajo qi thoni ju se jo veq qi nuk ka pase parti t' majte, por idete probolshevike u mblojshin pas perkimit me interesat gjasme patriotike (m' falni per perkthimin) asht kontradiktore. Derisa idete bolshevike ekzistojshin, partia ku qene personat-bartes t' tyne duhet definu si bolshevike, pavarsisht mnyres sesi u kamuflojshin kto ide.

3. Sa i perket “Krahut Kombëtar”. Ato që ka shkrujte z. Kastriot Dervishi nuk jane kontradiktore me ato qi kam shkrujte une. Une e kam analizu gjansisht ket organizate qi n' vitin 2000 (“Bota Sot”), n' disa shkrime, t' ribotume dhe prej shtypit e Tiranës (“Rimëkëmbja”), si dhe n' librin tem (2001). Ju bani mire qi i referoni kujtimeve t' Sejfi Vllamasit per ket organizate, kahse Vllamasi ka qene një prej krenve t' ksaj organizate. Por, ato qi thote Vllamasi, se organizata qe nacionaliste, nuk mjafton me e percaktue ate. Perndryshe duhen pa veprimet e saj. Dhe per ket gja mujten me u qite t' verteta t' terthorta dhe t' drejtperdrejta dhe prej kujtimeve t' Vllamasit.

Qi organizata qe e perbame ma teper prej toskësh dhe dojte me sundu shtetin shqiptar, tuj perdore gegë si vegla dhe dekoracion, kjo del dhe prej kujtimeve t' Vllamasit t' citume prej meje, kur thote se organizata zgjodhi midis kater personave t' pjeses s' Shqipnis londineze nalt Shkumbinit dhe mes tyne u zgjodh Ahmet Zogu. Sipas Vllamasit:

*Midis këtyre katër personave të Shqipërisë mbi Shkumbin, mbasi në Shqipërinë e nënShkumbinit fuqia personale nuk loste një rol me rëndësi, organizata “Krahu Kombëtar” përkrahu Zogun, sepse ai ka qenë i prerë për atë rol. ( Sejfi Vllamasi: “Ballafaqime politike në Shqipëri”, “Neraida”, Tirane 2000, f. 201.)*

Pra, asht e kjarte se ata qi e kontrollojshin organizaten dhe bane zgjedhjen qene toske, t’ cillet dojshin nji politikan dekorativ geg.

Se cillt qenë pikpamjet e Vllamasit per shqiptart e pjeses nalt Shkumbinit kjo kuptohet prej ktij fragmenti t’ kujtimeve t’ ktij zotnije prej vitit 1924:

“një ditë, afër akshamit, në kohën kur zakonisht kthehesha në shtëpi, colonel Ali Fehmi Kosturi, që banonte afër meje, në bri të portës së Petrelasve, në rrugën karshi shtëpisë së Jusuf Elezit sheh dy malokë në pritje. Ali Fehmiu menjëherë lajmëron shtëpinë time. Në atë kohë në shtëpi ndodhej miku dhe njeriu im Ferhat Veliu nga Homeshi, i cili menjëherë rrëmben pushkën dhe del nga dera. Malokët me ta parë u cdukën nëpër zik-zaket e rrugicave dhe unë shpëtova nga një vdekje e sigurt” (f. 357.).

E shikoni z. Kola sesi racisti Sejfi Vllamasi i qun matjant “malokë”, sipas frymes raciste t’ Klikes? E’ me mendu se katundi Novoselle i Kolonjes ku ka pase le Vllamasi asht n’ nji malsi t’ shkrete, qi nuk e gjen as n’ Mat dhe as n’ Tropoje (ndoshta veq n’ Kurvelesh).

“Krahu Kombëtar” (Kliken) ma sakte e ka analizu Mustafa Kruja n’ nji leter t’ shkrujtme pas LDB.

*“Koncepti programatik i tyre ishte: Gegnija asht nji grumbull fisesh primitive nan influencën personale të paris shekullare e klerikale, vetëm Tosknija asht popullsi e pjekun nga pikpamja shoqnore e politike, prandej e gatue me për t’ a sundue e çue përpara vendin në jetën shtetnore”. (“Hylli i Dritës”, Nr. 3-4, Tirane 1997, f. 27.)*

Ma tutje, Mustafa Kruja, n’ pershkrimin qi i ban “Krahu Kombëtar” shkrun:

*Por e kuptojshin se një programë me këtë frymë s’kishte si me u zbatue pa komplotitetin e disa elementëve gegë të tërhjekun me premtime e sigurime interesash ase me propagandë të përshtatçme me mendësinë ase sympathinë e antipathinë personale t’ secilit. (“Hylli i Dritës”, Nr. 3-4., Tirane 1997, f. 27.)*

Kshtu u zgjedh Ahmet Zogu. Por, ai m’ pas, kur e kuptoi lojen e Klikes, u prish me te dhe per ket shkak u ba Revolucioni i Qershorit. N’ 1914 Klika bani nji plan 100 vjeqar per sundimin e Shqipnis. Por per Kliken do paraqes dokumente autentike (burimin e atyne sot nuk e baj dot t’ ditun), tuj inkludu dhe “Programin sekret t’ Klikes” ku nuk perjashtohet dhe mbeshetja e komunizmit me siguru dominim n’ Shqipni.

5.Hymja e A. Zogut n’ politike. Paranteza qi bani per Luften e Pare Ballkanike asht e tepert madje e pasakte, kahse nuk qe Turqia ajo qi u shpalli lufte shteteve ballkanase, por kto i shpallen lufte Turqis. Pjesmarrja e Zogut n’ lufte kundra malazezve e serbve n’ ket kohe (1912) nuk provohet dot me shkrimet e Terenc Toçit, qi i ka ba kur pati qenë rroghtar i Zogut. Ate fjalimin qi ia ka vu n’ goje Zogut 17-vjeqar Toçi, asht nji gja e sajume, pasi nji 17 vjeqar nuk fol me ate gjuhe. Fakti asht qi Zogu nuk shkrepni asnji pushke kundra serbve n’ Mat n’ 1912. Apo doni me thane se ai e dojte Kakarriqin ma teper se Burgajetin?

6. Sa per vajtjen e Ahmet Zogut n’ Vlone, ai ka qenë atje n’ 1912, por jo n’ 28 nandor 1913 dhe kjo nuk ka kurrqja t’ keqe asht veq nji fakt historik. Ekrem beg Vlona, qi shfaq shume simpati per Zogun n’ kujtimet e veta, thote se ai ka ardhe ma vone dhe se ka bujte tek shpia e E. Vlones. Kjo asht nji dishmi qi nuk anashkalohet. Zogu e nanshkroi aktin kur shkoi n’ Vlone, qka e bajte ate pjesmarrs t’ Kuvendit, por nuk qe atje n’ 28 nandor. As dokumeti qi citoni ju nuk e pretendon ket gja, pra se t’ gjithë firmat jane hudhe n’ 28 nandor.

6. Zogu luftetar. Ato qi ka shkrujte Faik Konica per luftnat e Zogut nuk bani mire qi i citoni sot, se ato i ka shkrujte kur ka qenë rrogtar i Zogut. Do gjana nuk duhen permende sot. Ajo qi thoni ju se Noli u kndoi trimnive t' Zogut, tuj sjellë si prove nji shkrim t' Nolit t' botum tek "Dielli" n' SHBA, n' 1916, ku thuhet se Zogu ka vra 20 mije serbë dhe ka kapë 10 robën, asht nji gja qesharake qi ju nuk bani mire qi e citoni se hupni seriozitetin e gazetes tuj (Kur Zogu u ba mbret nuk e perdori ket histori me iu kundervu shamjeve t' Nolit). Noli n' Boston shkrujte qka i thojte fantasia, t' cilen e stimulojte dhe me alkool sipas atyne qi thote n' letrat e veta. Porn e sot e dijna mire se kto gjana nuk kane ndodhe dhe se nuk asht ba nji apo disa beteja ku Zogu paska ba ket kerdi mbi serbt. N' rast se do qe ba kjo lufte atehere ajo do t' u permendte n' Muzeun e Luftes n' Beograd si lufta e Lumes(1912), apo lufta e Dibres(1916), ku u vranë gjithsejt mbi 30 mije serbë, pet t' cillat u kerkohet serbve mos me i harrue kurre. N' rast se Zogu do qe njeriu qi e ka pase ba ket kerdi mbi serbt, ate nuk do ta pranojshin si mik n' Beograd n' 1919 dhe per ma teper n' 1924. Nuk do guxojte Pashiqi me u puthe me vrasesin e 20 mije serbve, kur gjaku i ktyne nuk qe tha hala!

7. Krahasimi me Zogut dhe Ismail Qemalit, qi bani ju tuj thane se Zogu pati sukses atje ku deshtoi Ismail Qemali, se "bëri zap armiqtë e brendshëm e të jashtëm", se "minjtë duan dacin", nuk vlen. Ismail Qemali qe nji "dac" i sprovun i Perandoris Osmane, qi pat ba zap shume province t' rebelume gjate karrieres s' vet shtetnore deri n' moshen 68 vjeqare, madje dije dhe me i zhduke "armiqtë", sikur bani me Pashko Vasen, t' cillin e helmoi, kur qenë valij fqinjë n' Liban e Siri, n' 1892. Por, ndryshimi qe tek situata nderkombtare. Ismail Qemalit nuk ia dhane licencen e "dacit" se dije ai si veprojte. Zogut ia dhane n' 1924 dhe e ndihmun, tuj e perdore si shtetar dekorativ britanikt dhe italiant. Si e perdori Zogu ket licence, e kam shpjegu n' studimin tem, me t' cilin ju replikoni me studimin tuj respektiv.

8. Sa per qashtjen e "shqipes letrare", n' gjuhen n' t' cillen po shkruaj une ka fillu me u shkrujte letersia shqipe qi n' shekullin XVI. E verteta asht se e ashtuqjtmja "gjuhë letrare shqipe" asht nji gjete e mjerueshme fiku qi nuk e mshef dot me lakuriqsin uni-dialektore qi permban. Gjithashtu du me iu kujtu dhe se gjuha n' t' cillen shkruj une ka qene dhe gjuha zyrtare shqipe n' kohen e monarkis dhe se n' ket gjuhe asht dhe deviza n' krye t' gazetes suj.

Kastriot Myftaraj